

albaqeramika Amfora

Botim i Albaqeramika
Edicioni numër 8
Dhjetor 2015

*Zgjedhja më e mirë për Festat e Fundvitit.
Ku ka më mirë se në shtëpi?*

www.albaqeramika.com

ALBA për sport

Është përgjegjësi shoqërore për çdo kompani të etabluar dhe të suksesshme që të gjejë mënyra për ta ndihmuar komunitetin dhe të ndikojë në zhvillimin e shoqërisë në ato aspekte që ajo i konsideron të nevojshme.

ALBA Qeramika asnjëherë nuk do të ndalet së ndihmuari të rinjtë kosovarë, kudo që ata do të tregojnë predispozita për punë dhe sukses.

Të rinjtë kosovarë kanë treguar vullnet dhe arritje në shumë fusha, por janë dalluar më së shumti në sport dhe këtë jo domosdoshmërisht vetëm në futboll, ku shumë yje kosovare kanë vënë vulën e tyre në shumë liga të njohura evropiane. Arritje të konsiderueshme janë arritur edhe në xhudo e basketboll dhe pikërisht këto dy fusha i ka zgjedhur ALBA Qeramika për të dhënë kontributin e vet.



Të gjithë tashmë e njohin si model të arritjeve ndërkombëtare xhudisten Majlinda Kelmendi, e cila na ka sjellur medalje të arta nga garat më të njohura në sportin që ajo e praktikon.

Ne kemi zgjedhur që ta mbështesim Majlindën edhe për suksese të mëtejshme, në mënyrë që gjeneratat e ardhshme ta kenë një model hapave të të cilit ata do të dëshirojnë të shkojnë.

Duke krijuar modele të tilla me arritje ndërkombëtare, ne besojmë se do të shtrojmë shumë rrugë të ndriçuara suksesi për gjeneratat e ardhshme.

ALBA Qeramika ka vendosur të përkrahë edhe dy prej ekipeve më të njohura në basketbollin tonë, që poashtu kohëve të fundit ka pasur shtrirje të madhe në sportin ndërkombëtar.

Suksesi i ekipeve tona basketbollistike në terrene ndërkombëtare forcon idenë se në Kosovë ia vlen të merresh me sport dhe ta kesh atë si profesion, prandaj edhe ne kemi vendosur që t'i mbështesim KB Pejën dhe KB Prishtinën.

Urime Viti i ri 2016

ALBA Qeramika sponsore e Majlinda Kelmendit

Në gusht të vitit 2015, ALBA Qeramika është vënë në krah të xhudistes kosovare Majlinda Kelmendi për ta përkrahur atë në suksese të mëtutjeshme.



Në një takim me Majlinda Kelmendin, trajnerin e saj Driton Kukën dhe pjesëtarët e tjerë të klubit të xhudos Ippon, është diskutuar rreth sukseseve të Majlindës dhe sportit të xhudos në Kosovë, si dhe përkrahjes që i duhet për të vazhduar me këtë ritëm fitues. Në atë takim u bë edhe nënshkrimi i

marrëveshjes mes palëve për të vërtetuar bashkëpunimin për një vit të tërë.

“Ne besojmë fuqishëm se sukseset në sport, janë mënyra më e mirë e promovimit tonë në botë, dhe tani kur sporti kosovar më në fund e ka mundësinë për të marrë pjesë në gara ndërkombëtare, përkrahja është edhe më e rëndësishme. Majlinda Kelmendi, me sukseset e saj është shembulli më i mirë i këtij promovimi dhe urojmë që këto suksese të kurorëzohen në Lojërat Olimpike në Brazil. Ne i urojmë

Majlindës dhe gjithë sportistëve kosovarë suksese, dhe zotohemi se do ta kenë përkrahjen tonë”, tha në këtë takim Fisnik Deçani, partner menaxhues në ALBA Qeramika.

Trajneri Driton Kuka theksoi se: “Mënyra më e mirë për të falënderuar përkrahësit e sportit, sikurse ALBA Qeramika, është që sportistët e klubit Ippon nga Peja, të udhëhequr nga Majlinda Kelmendi, të fitojnë sa më shumë gara, sepse fitoret e tyre janë edhe fitore të këtyre përkrahësve”.



Basketbolli, pjesë e suksesit të ALBA Qeramikës

Klubi i Basketbollit Sigal Prishtina, ka nënshkruar kontratë të re me kompaninë ALBA Qeramika, e cila do të jetë sponsore e këtij klubi edhe për vitin 2015-2016.

Marrëveshja përfshin mbështetjen e klubit dhe lojërave për periudhën 1 tetor 2015 – 1 qershor 2016, në Superligën e Kosovës në basketboll, Ligën Ballkanike si dhe Eurocup. Ceremonia e nënshkrimit të kontratës u mbajt në Prishtinë, ku të pranishëm ishin përfaqësues dhe lojtarë të Klubit të Basketbollit Prishtina, si dhe menaxhmenti i ALBA Qeramikës.

“Gjatë vitit të kaluar ne të gjithë i jemi gëzuar suksesit të Prishtinës, dhe padyshim të gjithë jemi ndier

pjesë e fitoreve të tyre. Përkrahja ndaj këtij klubi edhe për këtë vit është më se e natyrshme dhe i urojmë Prishtinës rezultate edhe më të larta”, nënvizoi me këtë rast Fisnik Deçani, partner menaxhues i ALBA Qeramikës.

Ekipi i basketbollit Prishtina përveç garave në Superligën e Kosovës, merr pjesë edhe në Ligën Ballkanike dhe në FIBA Europe Cup, gjë që e bën edhe më të rëndësishme përkrahjen ndaj këtij klubi. Florian Miftari, drejtor i klubit Prishtina, duke falënderuar ALBA Qeramikën për përkrahje, u zotua se këtë vit shikuesve do t’iu dhurojnë lojëra dhe rezultate edhe më të mira.

“Është kënaqësi kur shohim përkrahjen që kompanitë i japin klubit tonë. Kjo përveç se na ndihmon ne si ekip, është edhe një motiv më i madh për të arritur suksese edhe më të mëdha”, tha Miftari.

Si kompani lidere në industrinë e qeramikës, ALBA Qeramika çdo vit mbështet fusha të ndryshme, e sidomos fushën e sportit. Përkrahja ndaj klubit “Prishtina” do të vazhdojë deri vitin tjetër me shpresë që sporti në Kosovë të ecë përpara drejt sukseseve më të mëdha përmes pjesëmarrjeve të ndryshme jashtë vendit.



Zucchetti ISY stick red bateri e murit



Q - 15 - Rubinete e murit



Zucchetti Savoj
Tush bateri nga dyshemeja



Remer Liberty tush bateri



6018 Lavaman Machia



Ege lavaman Sura 70x44cm



52340R Lavaman Midas Bardhë/Ari



7101-7145 Lavaman 75x45

ALBA Qeramika sponsore e Klubit të Basketbollit Peja

ALBA Qeramika ka nënshkruar kontratë të re sponsorisimi edhe me Klubin e Basketbollit Peja për vitin 2015-2016. Marrëveshja përfshin mbështetjen e klubit dhe të lojërave për periudhën 1 tetor 2015 - 1 qershor 2016, në Superligën e Kosovës në basketboll si dhe në Ligën Ballkanike. Ceremonia e nënshkrimit të kontratës u mbajt në Pejë, ku të pranishëm ishin përfaqësues dhe lojtarë të Klubit të Basketbollit Peja, si dhe menaxhmenti i

ALBA Qeramikës. “Përkrahja e sportit është shumë e rëndësishme sidomos tani kur klubet tona po bëhen gjithnjë e më të pranishme në arenën ndërkombëtare. Ne besojmë fuqishëm se promovimi i një vendi mund të bëhet më së miri përmes sporteve prandaj edhe përkrahja jonë ndaj këtyre klubeve nuk do të mungojë”, spikati Valdet Deçani, partner menaxhues i ALBA Qeramikës. Edhe zyrtarët e Klubit Basketbollistik

Peja u shprehën falënderues për ndihmën dhe premtuan rezultate. “Ky është viti i dytë që kemi përkrahjen e ALBA Qeramikës dhe për këtë ne jemi shumë falënderues. Na mbetet ne që me lojërë të mira dhe me suksese të ua shpërblejmë këtë përkrahje. Ne zotohemi se do t’i sjellim përkrahësve të klubit tonë dhe gjithë qytetarëve të Pejës një lojë të mirë ku nuk do të mungojnë as titujt”, tha në këtë ceremoni Art Gashi, kryetar i klubit.

Të rejat në ALBA Qeramika

ALBA Qeramika i kushton rëndësi të veçantë zhvillimeve më të reja në fushën e qeramikës dhe sanitarisë si dhe ekonomisë në përgjithësi.

Gjatë këtij viti, ALBA Qeramika mori pjesë edhe në panairin ndërkombëtar të pllakave dhe produkteve sanitare “Cersaie 2015”, në Bologna të Italisë.

Gjatë kohës së panairit, përfaqësuesit e kompanisë patën takime të shumta me prodhues të ndryshëm dhe si rezultat edhe janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Mund të përmendim bashkëpunimin me Royo Group, ndër prodhuesit më të mëdhenj në Spanjë për dollapë të banjës.

Gjithashtu në ALBA Qeramika mund t’i gjeni produktet e kompanisë së mirënjohur botërore-Geberit, ku inovacioni, qëndrueshmëria dhe eko-efiçienca janë tri vetitë kryesore që karakterizojnë këtë markë. Me këtë bashkëpunim ALBA Qeramika rritë mundësinë e zgjedhjes së produkteve të sanitarisë për klientët e saj, gjithmonë duke ruajtur cilësinë dhe shërbimin që ofron.

Disa nga produktet të Lafaenza ceramica nga Italia:

www.youtube.com/watch?v=-dPAei451R0
- Le Essence

www.youtube.com/watch?v=-xz1pSY9Fe4
- Inedito



www.facebook.com/albaqeramika



twitter.com/ALBAQeramika



www.instagram.com/albaqeramika



+386 49 14 86 26 Prishtinë
+386 49 20 50 50 Pejë
+386 49 21 80 80 Prizren

Në Alba Qeramika mund të paguani edhe me POS të këtyre bankave :



ALBA Qeramika, km IV, magjistralja Prishtinë-Ferizaj 10000 Prishtinë
0038649206060
office@albaqeramika.com

Implementuar nga PROCON